

MENDIM PAKICE

Unë, komisionere Xhensila Pine, kryesuese e trupit gjykues, kam votuar kundër vendimit për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Enklid Gjini, me arsyetimin sa vijon:

(I) Lidhur me vlerësimin e pasurisë

1. Për sa i përket automjetit në përdorim tip “***”

1.1 Në përgjigjet e pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar në vitin 2008 se ka pasur në përdorim automjetin tip “***”, me prokurë të posaçme, me qëllim blerjeje.

1.2 Subjekti ka paraqitur prokurën e posaçme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.10.2008, me anë të së cilës shtetasja G. K., e datëlindjes 12.6.1940, ka autorizuar subjektin e rivlerësimit, z. Enklid Gjini, dhe bashkëshorten e tij “...të kryejnë çdo veprim për zhdoganimin e këtij automjeti, ta përdorin vetë pa asnjë lloj kufizimi brenda dhe jashtë vendit”.

1.3 Nga verifikimi i deklarimeve periodike rezultoi se:

1.3.1. Subjekti ka deklaruar në deklarin periodik vjetor të vitit 2008 se e ka blerë këtë automjet në vlerën 200.000 lekë, vlerë e cila nuk provohet nga asnjë dokumentacion ligjor provues për blerjen apo vlerën e automjetit, të cilat mbetën vetëm deklarative.

1.3.2 Subjekti ka deklaruar në deklarin periodik vjetor të vitit 2016 se e ka nxjerrë jashtë përdorimit për shkak të amortizimit të këtij automjeti. Nxjerrja nga qarkullimi e këtij automjeti nuk rezultoi e provuar me ndonjë akt ligjor dhe mbetet vetëm deklarative, në kushtet kur automjeti, i përdorur nga subjekti nga viti 2008, nuk ishte regjistruar asnjëherë dhe nuk ishin kryer procedurat e zhdoganimit të tij në Republikën e Shqipërisë. Për sa nxjerrja nga qarkullimi e këtij automjeti në kushtet kur ai nuk ishte futur asnjëherë në qarkullimin civil në Republikën e Shqipërisë ishte i pamundur të kryhej e nuk provohej me dokumentacion, subjekti vijonte të kishte të drejtën e përdorimit të këtij automjeti edhe në kohën e plotësimit të deklaratës *Vetting*.

1.4 Referuar situatës faktike për sa subjekti kishte detyrimin ta deklaronte këtë marrëdhënie në deklaratën *Vetting*, në zbatim të përcaktimeve të pikës 11 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit “*Pasuri janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit*”, ai ka bërë deklarin të pasaktë, duke mos e deklaruar përdorimin e këtij automjeti.

1.5 Përtej këtij konkluzioni, rezultoi se subjekti nuk shpjegoi se përse nëna e një oficeri policie, e cila në kohën e hartimit të prokurës së posaçme kishte moshën 68 vjeç, duhet të blinte një automjet të cilin, disa ditë pas futjes në territorin e Republikës së Shqipërisë do t’ia linte në përdorim me të drejta të pakufizuara dhe pa afat subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes.

1.6 Subjekti nuk shpjegoi se përse nga momenti i marrjes së prokurës më 21.10.2008 ai nuk lidhi kontratën e shitblerjes me pronaren e këtij automjeti. Deklarimi i subjektit se kontrata nuk u realizua pasi pronarja e automjetit jetonte jashtë, nuk mbështetet nga verifikimet në sistemin TIMS të kësaj shtetaseje, e cila pas dhënies së prokurës subjektit ka pasur vetëm disa udhëtime disaditore jashtë territorit të Shqipërisë, vetëm në datat 22.10.2008 – 30.10.2008, 14.12.2008 – 21.12.2008 dhe në vitin 2009 nga data 8.3.2009 deri më 18.3.2009 dhe nga data 8.6.2009 deri më 13.9.2009, duke mos mbështetur pretendimet e subjektit mbi pamundësinë e hartimit të kontratës së shitblerjes.

1.7. Subjekti nuk shpjegoi se përse ai nuk realizoi regjistrimin e automjetit apo pagimin e detyrimeve doganore, pavarësisht se pronarja e këtij automjeti e kishte autorizuar atë me prokurën e posaçme. Ai nuk shpjegoi se si e ka përdorur një automjet për një periudhë të gjatë disavjeçare, në shkelje të praktikave normale, pa kryer procesin e regjistrimit të këtij automjeti, në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 10 076, datë 12.2.2009, “Për sigurimin e

detyrueshëm në sektorin e transportit”, për pagimin e detyrimeve doganore dhe regjistrimin e mjetit pranë DRSHTRR-së, sipas parashikimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë.

1.8. Nga analiza që u bëhet të gjitha të dhënave që rezultuan nga burimet e provave sipas përcaktimeve të posaçme të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, rezulton se ekzistojnë një sërë rrethanash që nuk mund të injorohen e të konsiderohen si joekzistente, të tilla si:

- i) Ekziston marrëdhënia e subjektit të rivlerësimit me automjetin, për shkak të përdorimit pa kundërshtim, në mënyrë të pandërprerë, të qetë dhe për një kohë të gjatë e këtij automjeti.
- ii) Marrëdhënia e pronares me këtë automjet nuk krijon bindjen se ajo është pronarja *de facto* e këtij automjeti, duke pasur parasysh faktin se ajo nuk e ka përdorur asnjëherë këtë automjet.
- iii) I pyetur lidhur me vlerën, subjekti nuk e provoi vlerën e blerjes së këtij automjeti nga pronarja e tij apo mundësinë financiare për pronaren e automjetit lidhur me burimin e ligjshëm të kësaj pasurie dhe deklarimet e tij mbi pamundësinë nuk mbështeten nga faktet e rezultuara.
- iv) Nga momenti i marrjes në përdorim të këtij automjeti në vitin 2008 subjekti nuk ka paguar detyrimet doganore dhe regjistrimin e mjetit sipas parashikimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë për të.

1.9. Këto rrethana të çmuara në raport me njëra-tjetrën të çojnë në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit jo vetëm ka kryer deklarin të pasaktë në deklaratën *Vetting*, pasi nuk ka deklaruar përdorimin e këtij automjeti, por edhe ka ndërmarrë hapa për ta fshehur këtë pasuri dhe vlerën reale të saj, në kuptim të parashikimeve të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “c” të pikës 5 të nenit 33 dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

2. Për sa i përket automjetit në përdorim me targë ***

2.1 Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar marrjen në përdorim të automjetit me targë ***, në datën 29.10.2016, me qëllim për ta parë si punonte dhe, në rast se do t'i pëlqente, për ta blerë më pas.

2.2. Subjekti ka paraqitur kontratë huapërdorjeje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.10.2016, të lidhur mes shtetasit Enklid Gjini dhe shtetasit A. K., për ta përdorur këtë automjet pa ndonjë afat.

2.3. Nga dokumentet bashkëngjitur rezulton se ky automjet është blerë nga bashkëshortja e subjektit në datën 6.4.2017 prej shtetasit A. K., në shumën 550.000 lekë.

2.4. Deklarimet e subjektit mbi afatin e përdorimit apo kthimin e automjetit pronarit të tij nuk provohen me dokumentacion ligjor provues dhe mbeten deklarative, për sa nuk përputhen me parashikimet e kontratës së huapërdorjes së automjetit me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.10.2016, të lidhur mes shtetasve Enklid Gjini dhe A. K.

2.5. Për sa kohë kontrata e huapërdorjes së automjetit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.10.2016, e lidhur mes shtetasve Enklid Gjini dhe A. K., nuk është revokuar nga palët dhe ka qenë në fuqi dhe ajo konfirmonte përdorimin e këtij automjeti nga subjekti i rivlerësimit, subjekti vijonte të kishte të drejtën e përdorimit të këtij automjeti edhe në kohën e plotësimit të deklaratës *Vetting*.

2.6. Për sa më sipër, mosdeklarimi i përdorimit të këtij automjeti në këtë deklaratë, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 11 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, e bën deklarin e subjektit në këtë rast të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve në pikat 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 33, pika 5, shkronja “a” dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

3. Për sa i përket apartamentit të banimit 2+1, me sip. 88.5 m², të ndodhur në rrugën “*”, Tiranë. Vlera: 40.000 euro**

3.1 Si burim krijimi për këtë pasuri në deklaratën *Vetting* janë deklaruar: kësti i parë ishte paguar nga dhurata nga gjyshja në shumën 10.000 euro nga shitja e pasurisë dhe nga qiratë e ish-***, në Rrugën e ***, Tiranë; dhe këstet e tjera nga të ardhurat e subjektit dhe personit të lidhur nga pagat për periudhën 1996 – nëntor 2003, si dhe kursime nga pagat për vitet 2004 e 2005.

3.1.1 Sa i takon të ardhurave nga qiratë e ish-***, Rruga e ***, Tiranë, deklaruar në deklaratën *Vetting* si një nga burimet e dhuratës nga gjyshja në shumën 10.000 euro, nga hetimi nuk u provua pagimi i detyrimeve tatimore, ndaj edhe këto të ardhura nuk mund të merren në konsideratë në analizën financiare lidhur me këtë burim krijimi.

3.1.2 Arsyetimi i shumicës së trupit gjykues nuk mbështetet nga parashikimet ligjore në fuqi, pasi referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, ky nuk është një nga rastet kur qiramarrësi person fizik/tregtar, tatimpagues shqiptar, paguan shumën e qirasë, mban në momentin e pagesës tatimin mbi qiranë dhe ka detyrimin ta paguajë atë në organin tatimor si një tatim përfundimtar, për sa u provua se qiramarrësi ishte përfaqësia diplomatike e një shteti të huaj dhe jo tatimpagues shqiptar.

3.1.3. Në këtë rast, referuar veçorisë së marrëdhënies së qirasë dhe statusit të qiramarrësit, vetëm provueshmëria e pagimit të tatimit mbi të ardhurat nga qiradhënësja e pasurisë dhe dhuruesja e shumës 10.000 euro subjektit do të legjitimonte marrjen në konsideratë të tyre si burim krijimi për dhurimin e deklaruar, e cila nuk u arrit të provohet nga subjekti.

3.1.4 E vetmja shumë e përfituar nga gjyshja e subjektit, deri në kohën e dhurimit për të cilën u provua pagimi i detyrimeve tatimore, ishte 6.666 USD, shumë kjo e pamjaftueshme për të krijuar vlerën 10.000 euro dhe e paprovuar lidhur me kohën e përfitimit të saj prej dhurueses, dhe në mungesë të ndonjë shprehjeje vullneti të kohës për dhurimin e saj nga gjyshja e subjektit.

3.1.5 Sa më sipër, dhurimi, si burim krijimi për këtë pasuri, nuk mund të merrej në konsideratë, për sa nuk u provua me dokumentacion ligjor provues mundësia financiare e dhurueses që me të ardhura të ligjshme, për të cilat ishin paguar detyrimet tatimore, të krijonte shumën 10.000 euro.

3.1.6 Për sa dhurimi ishte deklaruar si burim i pagimit të këstit të parë të kësaj pasurie nuk mund të konsiderohet burimi për pagimin e këtij kësti nga mundësia financiare e subjektit.

3.2 Shumica e trupit gjykues ka marrë në konsideratë në analizën financiare dhe sa subjekti gjatë hetimit ka deklaruar se si burim për këtë pasuri të paluajtshme janë përdorur si vijon:

i) Prindërit e bashkëshortes i kanë dhuruar shumën 500.000 lekë, me rastin e lindjes së djalit në janar të vitit 2002. Në deklaratën *Vetting*, plotësuar nga subjekti, nuk është deklaruar ky burim.

ii) Në nëntor të vitit 2003, bashkëshortja Z. Gj. i ka marrë 500.000 lekë, në formën e huas, motrës së saj, shumë e kthyer në shkurt të vitit 2004, kur ka tërhequr edhe bonon e thesarit. Në deklaratën *Vetting*, plotësuar nga subjekti, nuk është deklaruar ky burim.

Lidhur me këtë pasuri objekt i deklarimit nga subjekti në deklaratën *Vetting* sipas nenit 3, pika 11 e ligjit nr. 84/2016, ai ka pasur detyrimin e pasqyrimin të të dhënave të sakta sipas “Shtojcës nr. 2” të ligjit nr. 84/2016, ndër të tjera edhe lidhur me burimet e krijimit të saj.

3.2.1. Për sa këto burime nuk janë deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting* si burim krijimi për këtë pasuri, ato nuk mund të merren në konsideratë dhe nuk duhen përfshirë si të ardhura të ligjshme për kryerjen e pagesave për blerjen e pasurisë objekt verifikimi.

3.2.2. Në një vlerësim të ndryshëm të analizës financiare nga shumica e trupit gjykues, referuar arsytimit të mësipërm lidhur me shumën e paguara për këstet e apartamentit, kam vlerësuar se

kryerja e analizës financiare, duke mos marrë në konsideratë huan dhe dhurimin nga të afërmit e bashkëshortes si burime të padeklaruara dhe dhurimin e deklaruar si të paprovuar për sa i përket burimit të ligjshëm të krijimit, do të sillte një rezultat negativ në analizën financiare të subjektit dhe personit të lidhur, për sa i përket pagimit të çmimit të kësaj pasurie të paluajtshme.

3.2.3 Mungesa e burimeve financiare të krijimit të kësaj pasurie e vendos subjektin në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, të parashikuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenin 61, pika 3 dhe në nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

4. Për sa i përket apartamentit 1+1, me sip. 53.5 m², të ndodhur në rrugën “*”, Tiranë. Vlera: 1.900.000 lekë**

4.1 Si burim krijimi për këtë pasuri në deklaratën *Vetting* është deklaruar kredia në NBG në shumën 20.000 euro, marrë në datën 6.12.2007, me objekt “Blerje/rikonstruksion banese”.

4.2. Nga hetimi ka rezultuar se me kontratë shitjeje pasurie të paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.11.2007, shtetasit Z. Gj. e E. Gj. kanë blerë nga shtetasit K. D. e A. D. apartamentin nr. ***, për vlerën 1.900.000 lekë. Ky apartament ndodhej në të njëjtin kat e në të njëjtin ndërtim me apartamentin e sipëranalizuar. Blerja e këtij apartamenti është deklaruar në DPV-në e vitit 2007 në të njëjtën mënyrë dhe me të njëjtin çmim, 1.900.000 lekë, sikurse kontrata e parashikonte, likuiduar plotësisht jashtë zyrës noteriale.

4.3. Në praktikën e kredisë rezulton e depozituar deklarata e datës 25.10.2007, hartuar mes palëve shitëse e blerëse, sipas së cilës shitësit K. dhe A. D. deklaronin se i shesin blerësve Enklid dhe Z. Gj. apartamentin me sip. 53.5 m², në shumën 30.000 euro, dhe blerësit Enklid dhe Z. Gj. deklaronin se i kishin likuiduar shitësve në këtë datë shumën 10.000 euro dhe diferencën prej 20.000 euro do t’ua shlyenin përmes kredisë.

4.4. I pyetur në lidhje me likuidimin e çmimit të shitjes, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti deklaroi se në momentin e përpilimit të kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.11.2007, ku palët deklaruan se kishin likuiduar çmimin e blerjes prej 1.900.000 lekësh, në fakt nuk ishte bërë asnjë pagesë duke deklaruar se çmimi i blerjes ishte vlera 20.000 euro, paguar me kredi.

Referuar vlerësimit të kolateralit nga banka për dhënien e kredisë, vlera e apartamentit ishte 37.000 euro. Referuar udhëzimit nr. 2, datë 4.4.2007 “Për kosto mesatare të vlerave në tregun e lirë të banesave dhe të koeficientit “K” për vitin 2007” për qytetin e Tiranës, vlera e këtij apartamenti do të rezultonte 5.674.500 lekë.

4.5. Nga sa më sipër, në drejtim të vlerësimit të pajtueshmërisë së përmbajtjes së deklarimeve të subjektit me provat e administruara, kam vlerësuar se nga trupi gjykues duhet të merrej në konsideratë vlera e paguar për blerjen e pasurisë apartament, e provuar nga hetimi administrativ, ishte sa: (i) sipas kontratës së shitblerjes së pasurisë të lidhur mes palëve, nr. *** rep. nr. *** kol., datë 21.11.2007, referohet se çmimi 1.900.000 lekë është shlyer totalisht jashtë zyrës noteriale; (ii) të dhënat bankare dëshmojnë se edhe një vlerë prej 20.000 euro ka kaluar në llogarinë e shitësve, në datën 7.12.2007, prandaj dhe këto vlera duhet të ishin marrë në konsideratë në analizën financiare të kryer për blerjen e kësaj pasurie apartament.

4.6. Kryerja e analizës financiare duke marrë në konsideratë shumën 1.900.000 lekë, paguar në datën 21.11.2007 dhe 20.000 euro, paguar në datën 7.12.2007, si vlera e paguar për blerjen e pasurisë apartament, do të sillte një rezultat negativ në analizën financiare të subjektit dhe personit të lidhur, për sa i përket pagimit të çmimit të kësaj pasurie të paluajtshme.

4.7. Mungesa e burimeve financiare të krijimit të kësaj pasurie e vendos subjektin në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, të parashikuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenin 61, pika 3 dhe në nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

4.8. Në përfundim, bazuar në konkluzionet e arritura më lart lidhur me kriterin e pasurisë, në konsideratë edhe të standardeve të vendosura nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, kam arritur në

konkluzionin se subjekti i rivlerësimit z. Enklid Gjini, nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

(II) Lidhur me vlerësimin e figurës

5. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera dhe ka dërguar raportin e rishikuar mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Enklid Gjini.

5.1. Në vlerësim të të dhënave që disponohen nga autoritetet verifikuese për subjektin e rivlerësimit, elementeve që evidentojnë përfshirjen e tij në veprimtari korruptive, integriteti profesional është përcaktues për pastërtinë e figurës së subjekteve të rivlerësimit.

5.2. Informacionet që disponohen në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, për implikim në veprimtari korruptive të funksionarit të drejtësisë, në këndvështrimin e përgjithshëm të kontrollit të pastërtisë së figurës së subjektit të rivlerësimit, janë vlerësuar se cenojnë pastërtinë e figurës së subjektit dhe shkallën e besueshmërisë së tij.

5.3. Në përfundim, Grupi i Punës, nisur nga të dhënat e siguruar nga autoritetet verifikuese, ka ndryshuar konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit, nga përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës në papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës.

5.4. Komisioni, nga informacioni i dhënë në raportin e sipërcituar, në përputhje me paragrafin 4 të nenit 41 të ligjit nr. 84/2016, e shtriu hetimin administrativ duke kërkuar informacion në lidhje me procedimin penal të vitit 2015, që i përkiste shtetasit I. Sh., si dhe me procedimin penal nr. ***, viti 2005 që i përkiste shtetasit S. L.

5.5. Pas kërkesës së Komisionit, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë depozitoi në Komision vetëm dosjen e procedimit penal të vitit 2015, që i përkiste shtetasit I. Sh., ndërsa për procedimin penal nr. ***, viti 2005, informoi se kopja e fashikullit nuk mund të vihej në dispozicion, pasi nga verifikimet e kryera nuk rezultoi që fashikulli të ishte dorëzuar pranë zyrës së arkivit.

5.6. Kur nga ana e Komisionit u kërkuar informacion i mëtejshëm në lidhje me prokurorin, i cili kishte pasur në trajtim këtë çështje, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë informoi se procedimi penal nr. ***, viti 2005, për të cilin është marrë vendim për pushimin e çështjes penale në datën 11.11.2005, është regjistruar dhe hetuar vetëm nga prokurori S. H.

5.7. Për të mundësuar verifikimin e të dhënave konkrete që referoheshin në informacionet lidhur me figurën e subjektit të rivlerësimit Enklid Gjini, kam vlerësuar se Komisioni duhet të vijonte kërkimin mbi gjetjen dhe vënien në dispozicion të fashikullit lidhur me procedimin penal nr. ***, viti 2005, si dhe çdo procedim tjetër të regjistruar për shtetasin S. L., jo vetëm si individ, por edhe si funksionar shtetëror pranë Ministrisë së Punës Sociale dhe Shanseve të Barabarta, në detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm, në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, nga data 19.6.2003 deri në datën 12.12.2005, për të mundësuar verifikimin dhe arsyetimin lidhur me të dhënat që referoheshin në informacionet lidhur me figurën e subjektit të rivlerësimit.

5.8. Përveç sa më sipër, nga analiza e akteve të procedimit tjetër penal nr. ***, viti 2015, administruar nga Komisioni për të njëjtin kriter, atë të vlerësimit të figurës, në drejtim të rezultateve të hetimit, të dërguara subjektit lidhur me të, sipas të cilave vendimi i pushimit të procedimit penal të datës 22.9.2015 ishte në kundërshtim me provat e administruara gjatë hetimit, pasi nga akti i ekspertimit autoteknik u provua shkelja e rregullave të Kodit Rrugor nga ana e personit që i atribuohet vepra penale, ndërsa nga akt-dëshmia mjekoligjore u provua pasoja e ardhur, plagosja e rëndë dhe ndryshe nga sa arsyetohej në urdhrin e regjistrimit të procedimit penal për veprën penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/2 i Kodit Penal ndaj personit që i atribuohet vepra penale, në vendimin e pushimit arsyetohej mbi mungesën e veprës penale të parashikuar nga neni 290/1, e cila kërkonte si

pasojë plagosjen e lehtë të disa personave, në kuadër edhe të çmuarjes së shpjegimeve që ka dhënë subjekti, kam arritur në konkluzionin se informacionet që disponoheshin në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, z. Enklid Gjini, sipas kërkesave të shkronjave “b” dhe “c” të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016, ishin të bazuara në fakte dhe rrethana konkrete.

5.9. Në këndvështrimin e përgjithshëm edhe nëse ky konkluzion nuk do të ishte i mjaftueshëm për të arritur në një konkluzion lidhur me kontrollin e pastërtisë së figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Enklid Gjini, ai cenonte pastërtinë e figurës së subjektit dhe shkallën e besueshmërisë së tij në zbatim të pikës 2 të nenit 4 dhe pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

5.10. Rrethanat që përmban praktika e procedimit penal, analizuar në funksion të këtij kriteri vlerësimi dhe praktikat e procedimeve penale, analizuar në funksion të denoncimeve, referuar gjetjeve të dërguara me rezultatet e hetimit dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti, kanë dëshmuar se subjekti i rivlerësimit ka krijuar kushtet e klimës së pandëshkueshmërisë në sytë e publikut, duke cenuar besimin e publikut te drejtësia, sipas pikës 2 të nenit 4 dhe të pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

6. Kam votuar për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Enklid Gjini, pasi kam arritur në konkluzionin se ky subjekt:

- ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë në kuptim të parashikimeve të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “b” të pikës 5 të nenit 33 dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016;
- ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve në pikat 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 33, pika 5, shkronja “a” dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016;
- ka ndërmarrë hapa për të fshehur pasurinë në kuptim të parashikimeve të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “c” të pikës 5 të nenit 33 dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016;
- në vlerësimin tërësor ka cenuar besimin e publikut te drejtësia në kuptim të parashikimeve të pikës 2 të nenit 4 dhe pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

Xhensila PINE
Kryesuese (kundër)